

Në lidhje me kërkesën bëjmë me dije se, sa i takon barnave që tregtohen në farmacite spitalore dhe konkretisht për barnat që përdoren për trajtimin e të semurve me hemodializë ekziston hapi indermjeter i konfirmimit të recetes nga punonjësi i caktuar i Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Universitar (DSHSU) ose Drejtorisë Rajonale të Fondit (DRF).

Konfirmimi i këtyre recetave elektronike bëhet për arsye të përzgjedhjes së alternativës së barit, të pagesës së diferencës së vlerës në rastin e barnave me bashkëpagese (kur nuk përzgjidhet alternative e parë), si dhe kontrollit të recetës për pasaktësi. Koha e ekzekutimit të recetave nga farmacia, pasi është plotësuar nga mjeku, është deri në 7(shtatë) ditë.

Për barnat që tregtohen në farmacite të rrjetit të hapur nuk ekziston ky proces konfirmimi. Në lidhje me informacionin për shërbimin e dializës, theksojmë se për këtë informacion çdo i interesuar mund t'i referohet protokollit të dializës, në aneksin nr.1 pjesë përberëse e Kontratës për financimin e paketave të shërbimit në institucionet shëndetësore jopublike për vitin 2023, të cilën mund ta aksesoni në faqen zyrtare të FSDKSH, në linkun:

https://fsdksh.gov.al/ep-content/uploads/2022/12/Kontrata-DSHSU_DRF-Institucioni-Shendetesor-Jo-Publik-2023.pdf.